



Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve  
Nacionalni Autoritet za Kualifikacije  
National Qualification Authority

# ZHVILLIMI DHE VERIFIKIMI I **STANDARDEVE PROFESIONALE**



Projekt i financuar nga BE-ja dhe i menaxhuar  
nga Zyra ndërlidhëse e Komisionit Evropian

PRISHTINË, 2011



**EU KOSVET V**

Zhvillimi i Sigurimit të Cilësisë, Akreditimit dhe Zhvillimi i AKK & KKK në Kosovë

**Nr. i Projektit: 2009/216-809**

Ky publikim është hartuar me përkrahjen e Bashkësisë Evropiane.  
Përbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e kontraktorit PEM GmbH dhe në asnjë mënyrë nuk mund t'i pasqyrojë pikëpamjet e Bashkësisë Evropiane.



# PËRMBAJTJA

Pikëpamje e ndryshimeve të AAP-së	6
Prezantim i përgjithshëm i Standardeve Profesionale dhe Standardeve të Aftësisimit	8
Standardet Profesionale	8
Analiza Profesionale	11
Zbatimi i Analizës Profesionale	13
Verifikimi dhe Validimi i të dhënave që rezultojnë nga Analiza Profesionale	18
Përcaktimi i Funksioneve dhe Aktiviteteve Kyçe	20
Zhvillimi i Kriterit të Përformancës dhe Kushtet e realizimit të funksionit	22
Zhvillimi i Kërkesave të Dëshmive	24
Lista Kontrolluese e Zhvillimit të Standardeve Profesionale	25
Zhvillimi i Standardeve Profesionale – Modeli i përgjithshëm	26
Kriteret për caktimin e Cilësisë së Standardeve Profesionale	32
Lista kontrolluese për Cilësinë e Standardeve Profesionale	33
Formati i Standardeve Profesionale	35

# PIKËPAMJE E NDRYSHIMEVE TË AAP-SË

Të gjithë ne jetojmë kohën e ndryshimeve. Në mënyrë që t'i përshtaten zhvillimeve të paevitueshme të jetës, organizatat publike ose ato private, duhet ti përgjigjen shpejtë dhe në mënyrë efektive ndryshimeve shoqërore, teknologjike, ekonomike dhe politike.

Aspekti i konkurrencës nuk caktohet vetëm me zhvillimin e teknologjisë së re dhe të lartë por më tepër për nga përgatitja e personelit.

Bota e shkollës nuk është një sistem i pavarur. Ajo ekziston por funksionon dhe zhvillohet në marrëdhënie me botën e punës, me industrinë në fakt.

Produkti përfundimtar i shkollës- individi i aftësuar- është një kontribut për një kompani që siguron mallra dhe shërbime, dhe sa më kompetent që është individi, më e lartë do të jetë cilësia e produktit dhe shërbimeve që sigurohen nga kompania.

Në mënyrë që të mundësohet një gjë e tillë, kompania duhet ti tregojë shkollës se të priturat e saj janë në përputhje të plotë me kompetencat e të diplomuarve, meqenëse ata i përkasin arsimit fillestar, ose edhe të rriturit që kërkojnë shkathtësi të reja apo përmirësimin e aftësive ekzistuese.

## Kompetenca

Në thelbin e sistemit të AAP-së qëndron koncepti i kompetencës. Kompetenca nënkupton aftësinë për të përdorur njohurinë, shkathtësitë, dhe qëndrimet në mënyrë që të realizojmë aktivitetet e punës dhe që të arrihen rezultatet e pritura.

Fjalori i ETF për terminologjinë e Tregut të Punës dhe Standardet dhe Termet e Zhvillimit të Kurrikulit (FET 1997) jep tri përkufizime të kompetencës emër

1. Aftësinë për të bërë diçka mirë dhe në mënyrë efektive
2. Aftësinë për të plotësuar kërkesat e punësimit
3. Aftësinë për të përmbushur kërkesat e roleve specifike të punës.

Të gjitha përkufizimet merren me punë. Të jesh kompetent nënkupton të prodhosh rezultate të punës. Me dy fjalë kompetenca përfshinë diturinë dhe veprimin. Rezultati i të dyve duhet të nënkuptoj rezultatet e pritura në punë, duke qenë produkt i tij ose shërbim. Kështu që koncepti përqendrohet në atë që pritet nga një punëtor më tepër se procesin e mësimit nëpër të cilin ai/ajo ka kaluar.

Kompetenca përfshinë të gjitha aspektet e kryerjes së punës, jo vetëm aftësinë/ shkathtësinë për të kryer detyrat dhe përmbushur ato:

- Aftësinë për të kryer detyrat e rregullta të një profesioni (shkathtësitë e detyrave)
- aftësinë për t'u marr me një kombinim të këtyre detyrave dhe për ti realizuar ato në nivelin e pritur të realizimit (shkathtësitë e menaxhimit të detyrës)
- aftësinë për t'u marr me situatat e pa pritura të cilat mund të shfaqen gjatë punës (shkathtësitë e menaxhimit të rastësive)
- kapacitetin për t'i integruar detyrat e juaja në vendin e punës ( shkathtësitë e vendit/rolit të ambientit)

**Shkathësitë e Detyrës** merren me kërkesat e detyrave të veçanta në vendin e punës në përputhje me metodat dhe procedurat e caktuara.

#### **Shembujt**

Bashkimi i elementeve të drurit në përputhje me specifikat e ndërtimit të definuara në plan. (nga standardi profesional i zdrukthëtarit)  
Siguroni informacione turistike për klientët (nga standardi profesional i portierit)

**Shkathësitë e menaxhimit të detyrës** paraqesin shkathësinë për të administruar/ menaxhuar detyra të ndryshme. Komponenta tërheq aftësinë e një individi për ti integruar një numër të detyrave të ndryshme për të arritur një rezultat të plotë.

#### **Shembujt**

Planifikimi i aktiviteteve në mënyrë që të përmbushen afatet kohore (nga pothuajse cilido standard profesional)

Përzgjedhja e materialeve të përshtatshme për të përmbushur kërkesat e standardeve të cilësisë (nga cilido standard profesional i cili ka të bëjë me prodhimin e mallrave)

**Shkathësitë e menaxhimit të rastësive** nënkuptojnë kërkesën për të iu përgjigjur situatave të papritura. Kjo është gjithashtu një aftësi e cila ka të bëjë me administrimin e detyrave jo-rutinore.

#### **Shembujt**

Ofron ndihmën e parë në mënyrë të saktë dhe me kujdes për integritetin e personit të lënduar (nga pothuajse cilido standard profesional i cili ka të bëjë me shëndetin dhe sigurinë)

Vlerëson situatën dhe ç'kyç makinën në raste të ndërprerjes së furnizimit me rrymë elektrike (nga standardi profesional për operator në industri)

**Shkathësitë e vendit të punës** paraqesin kërkesën për t'u marr me përgjegjësitë dhe pritjet e vendit/ ambientit të punës. Kjo kërkesë i referohet punës ekipore, bashkë veprimin me klientët, kolegët, pozitat hierarkike, komunikimi efektiv me të tjerët.

#### **Shembujt**

Adresoni problemin të personeli i përshtatshëm në raste të ndërprerjes së furnizimit me energji elektrike. (nga standardi profesional për operator në industri)  
Trajtoni në mënyrë të duhur kërkesat e klientëve këmbëngulës (nga fusha e bankave)

# PREZANTIM I PËRGJITHSHËM I STANDARDEVE PROFESIONALE DHE STANDARDEVE TË AFTËSIMIT

## STANDARDET PROFESIONALE

Standardet profesionale janë njësi që pasqyrojnë realizimin e punës e cila pasqyron shkathtësinë për të realizuar me sukses funksionet e kërkuara të një profesioni si dhe aplikimin e njohurive, shkathtësive, dhe të kuptuarit në një profesion.

Standardet profesionale janë të definuara në kuadër të **aktiviteteve të kryera** nga një person në kuadër të profesionit të caktuar ndërsa standardet e arsimit dhe aftësisimit janë zhvilluar nga aktivitetet e përcaktuara në standardet profesionale, dhe ato përfshinë **rezultatet e të nxënit dhe aktivitetet e mësim nxënies** të cilat sigurojnë zhvillimin e shkathtësive dhe njohurisë së domosdoshme nga një person për ti mundësuar atij ose asaj kryerjen e funksionit në një nivel të përshtatshëm profesional.

Zhvillimi i një formati të përbashkët për standardet profesionale mundëson konsistencën kombëtare dhe do të ndihmojë për t'u siguruar se standardet janë lehtësisht të kuptueshme nga përdoruesit e ndryshëm, dmth punëdhënësit, administruesit e BNJ-së, mësimdhënësit, / trajnerët, planifikuesit e aftësisimit dhe menaxherët, individët.

Formatet ndryshojnë midis zhvilluesve të standardeve dhe shteteve. Lista vijuese përshkruan pjesët e përbashkëta të formateve të përdorura në shtete të ndryshme:

**Funksionet e gjera** – të cilat i referohen funksioneve të ndryshme në një profesion. Zakonisht standardet janë ndërtuar nga njësitë e kompetencës. Një njësi i referohet kompetencës e cila kur aplikohet në situatë të punës, logjikisht mund të qëndroj si e vetme. Ajo përfshinë një titull, i shprehur në kuadër të rezultateve të nxënit, dhe një përshkrim i cili sqaron titullin e njësisë dhe ofron të dhëna mbi raportin me njësitë tjera nga i njëjti standard apo ato përkatëse. Njësia e kompetencës është pjesa më e vogël e kualifikimit e cila mund të njihet me një certifikatë të veçantë.

### Shembujt

Standardet Britanike për profesionin e saldiesit Njësia T/102/3947 – Njësia 22 – Prerja e shtresave të metalit për ta formësuar atë duke përdorur vegla dore dhe makina, Ose Njësia – M/102/3932 – Njësia 07- ngjitja e materialeve përmes procesit të saldimit manual me gaz.

Standardi Australian për profesionin e saldiesit (Njësia RUAME5.15A) Procesi i saldimit me hark metalik (MMAW)

Standardet Rumune janë të një strukture të ngjashme si kjo:

Sipas Ligjit për arsimin e të rriturve në Rumuni njësia e kompetencës paraqet aktivitetin kryesor në një profesion i shoqëruar me rezultate dukshme dhe të matshme.



**Aktivitate Kyçe** – paraqesin veprimet e lidhura me kryerjen e detyrës së funksionit. Shumë standarde lidhin aktivitetet kyçe me elementet e kompetencës që paraqesin blloqet themelore ndërtuese të njësisë dhe vazhdojnë përshkrimin e qëllimit kryesor të vetë njësisë. Ato përshkruajnë, në kuadër të rezultateve, aktivitetet të cilat ose veprimtaritë që një person i cili punon në një fushë të veçantë është në gjendje ti kryej. Elementet përshkruajnë veprimet ose rezultatet të cilat janë të provueshme dhe të vlerësueshme. Është shumë e rëndësishme që në rast se elementet e një njësie të caktuar të kompetencës **nuk janë** të radhitura si detyra të lidhura për funksionin e përshkruar në njësi.

#### **Shembull**

Njësi – Procesi i saldimit me hark metalik (MMAW)  
Elementet – Përgatitja e metalit për saldim.  
Përzgjedhja e elementeve të makinës salduese dhe elektrodave.  
Identifikimi i masave parandaluese ndaj ndryshimeve.  
Saldimi i materialeve përmes një procesi korrekt dhe në përputhje me cilësinë e përshkruar në standardin përkatës.  
Inspektimi i saldimeve.  
Korrigjimi i gabimeve.

**Deklaratat e Përformancës** janë deklarata vlerësuese të cilat përcaktojnë se çfarë është për t'u vlerësuar si dhe nivelin e kërkuar të përformancës. Deklaratat e Përformancës (të gjetura në shumë standarde si kritere të përformancës) përkufizojnë nivelin e krahasimit të cilësisë së përformancës së veprimit të përshkruar në elementin e kompetencës.

Niveli i krahasimit i referohet ose vetë atij veprimi, ose shpesh herë rezultatit të veprimit.

#### **Shembull**

Elementi – Përgatitja e metaleve për saldim  
Kriteri i Përformancës – Saldimi i kërkesave të identifikuar nga specifikat dhe/ose vizatimet-skicat.  
Materiali është përgatitur si duhet duke përdorur pajisjet dhe teknikat e përshtatshme.  
Materiali i mbledhur dhe / rregulluar për specifikim aty ku kërkohet.

**Deklarata e Kontekstit** – Deklarata rreth kontekstit brenda së cilit duhet të arrihet realizimi. Kjo mund të referoj gamen e pajisjeve ose veglave të përdorura për kryerjen e funksionit të përshkruar nga njësia, ambientet ku veprimet mund të ndodhin. Deklarata e kontekstit e siguron përdoruesin me kontekstin e funksionit, siguron një lidhje për njohuri dhe kërkesa të ndërmarrjes, dhe i ndihmon përdoruesit për të siguruar një fokus të vlerësimit, dhe ndihmon në përditësimin e standardeve pas shqyrtimit të tyre. Deklarata mbi Kontekstin ( e cila në disa standarde figuron si varg i variablave apo kushtet e realizimit të funksionit ) ka të bëjë me njësinë e kompetencës si tërësi.

### **Shembull**

Kushtet e realizimit të funksionit-

- Kjo punë do të kryhej duke përdorur një sërë materialesh për fabrikime të rënda dhe të lehta.
- Personi do të punonte në mënyrë të pavarur ose si pjesë e ekipit duke përdorur standardet e paracaktuara të cilësisë, procedurat e sigurisë në punë dhe procedurat e saldimit si dhe shkathtësitë e aplikuara tek një sërë aktivitetesh të fabrikua.
- Cilësia e saldimit përmbush standardin deri në nivelin AS1554 GP ose të barasvlershme
- Materialet mund të përfshijnë çelikon e karbonit ose çelikon e pandryshkur, etj.
- Përgatitja e materialeve përfshinë para-ngrohjen, vendosjen e grepave, orendi instaluese, mendenetë, etj.
- Procedurat e testimit mund të përfshijnë rënien e tensionit, vendosjen e korrentit në apter (amperazhin), tokëzimin, elektrodën dhe telin e përçueshmërisë, elektrodën e gjendjes së fluksit –zbrazjes, etj.

**Udhëzuesi i Dëshmimeve** ose **udhëzuesi i vlerësimit** lidhet drejtpërdrejtë me deklaratën e performancës dhe kushtet e realizimit të funksionit.

Qëllimi i tij është të drejtoj vlerësimin e njësisë së kompetencës qoftë në vend të punës dhe /ose në kuadër të programit të aftësisimit.

Në thelb udhëzuesi i dëshmimeve e udhëzon vlerësuesin se çfarë të shikoj në një kandidat në mënyrë që të sigurohet se kandidati mund të shpallet si kompetent.

Udhëzuesi i dëshmimeve zakonisht i referohet aspekteve vijuese:

Aspektet kritike të dëshmimeve të merren parasysh Vlerësimin bashkëveprues dhe ndërvarësi me njësitë tjera të kompetencës.

Njohurinë mbështetëse

- Metoda(t) e rekomanduara të vlerësimit.
- Kompetencat kyçe të lidhura me njësinë e kompetencës.

**Standardet e Arsimit dhe Aftësisimit** janë zhvilluar nga aktivitetet e përcaktuara në standardet profesionale. Ato përfshijnë rezultatet të cilat përshkruajnë atë që njerëzit do të jenë në gjendje ta bëjnë në fund të programit mësimor. Ato gjithashtu mund të përfshijnë objektivat për të siguruar atë që të funksionoj në një nivel të miratuar të profesionit.

Derisa **standardet profesionale** fillojnë nga rezultatet e punësimit dhe përkufizojnë kompetencat e kërkuara në një profesion, **standardi i aftësisimit** fillon nga kompetenca e cila synohet të arrihet, njëherit përkufizon rezultatet e të nxënit dhe përmban informata tjera si:

- Përmbajtjen e mësimit të lidhur për rezultatet e të nxënit, p.sh. aktivitetet mësimore të nevojshme për të fituar shkathtësi dhe njohuri, metodat e mësimdhënies, etj.
- Vlerësimi i të arriturave, p.sh. metodat e vlerësimit, dëshmitë e të arriturave.
- Kërkesat e procesit, p.sh. përgjegjësitë, kohëzgjatja e programeve, lokacioni i pranueshëm dhe i dëshirueshëm i mësimit.

## ANALIZA PROFESIONALE

Zhvillimi i një standardi profesional kërkon të dhëna të përgjithshme dhe të sakta rreth shkathtësive, njohurisë, dhe kompetencave të nevojshme për një performancë të mirë.

Informacionet mund të merren nëpërmjet një procesi të analizës së profesionit në mënyrë të arsyeshme dhe të strukturuar. Analiza profesionale është faza më e rëndësishme gjatë organizimit të një standardi profesional.

Ekzistojnë teknika të ndryshme për mbledhjen e të dhënave në lidhje me një profesion, pra vëzhgimi i punës, intervistat (individuale apo ato grupe), pyetësorët, rishikimet e dokumentacioneve ekzistuese (përshkrimet e vendit të punës, standardet profesionale nga vendet tjera, përshkrimet e proceseve teknologjike, etj.) dhe konferencat. Të gjitha këto teknika kanë përparësi dhe dobësi, dobitë dhe dëmet kështu që përdorimi i kombinimit të tyre do të ishte më i këshillueshëm, nëse kemi nevojë të marrim një imazh të qartë rreth një profesioni ose një pjese të tij.

Analiza Profesionale funksionon sipas parimeve në vijim:

- Ekspertët të cilët punojnë në profesionin përkatës janë më të aftë të ofrojnë informacione mbi profesionin sesa kushdo qoftë tjetër;
- Çdo profesion mund të analizohet në kuadër të shkathtësive kyçe të përdorura në atë profesion dhe funksionet kryesore të cilat i kryejnë njerëzit;
- Të gjitha shkathtësitë dhe funksionet lidhen drejtpërdrejtë me njohurinë të cilën punonjësi duhet ta ketë në mënyrë që të kryej profesionin.

Përveç përdorimit për zhvillimin e programeve mësimore, të dhënat nga analiza profesionale mund të përdoren për

- Kontrollimin e shkathtësive të kërkuara në një profesion;
- Zhvillimin e përshkrimit të vendit të punës;
- Rishikimin e lidhshmërisë së programeve ekzistuese të aftësisë;
- Përmirësimin e metodave të përdorura në një profesion;
- Themelimin e bazës për rekrutimin korrekt të stafit / personelit;
- Vlerësimin e performancës së stafit;
- Planifikim dhe zgjidhjen e problemit;
- Shkrimin e standardeve.

Analiza profesionale është një metodë e zbrërimit të një profesioni në dy kategori të përbërësve. Në njërën anë ekzistojnë aktivitete të kryera në një profesion të shoqëruara nga rezultatet e pritura (rezultatet). Ndërsa në anën tjetër ne përkufizojmë njohurinë, shkathtësitë, qëndrimet dhe kërkesat e performancës (KSAPR) të domosdoshme për të arritur rezultatet e pritura.

Zakonisht të dhënat që dalin nga analiza profesionale nuk mund të përpunohen drejtpërsëdrejti në standarde profesionale. Zhvilluesit e standardeve duhet të interpretojnë, kategorizojnë, mbledhin dhe analizojnë të dhënat për të krijuar standardin.

Një analizë profesionale përmban 4 faza:

1. Identifikimin e profesionit
2. Zhvillimin e kornizës së shkathtësive
3. Identifikimin e funksioneve kryesore
4. Organizimi i shkathtësisë, njohurisë, aktiviteteve, kërkesave të performancës.

## **TEKNIKAT E PËRDORURA GJATË MBLEDHJES SË TË DHËNAVE PËR ANALIZËN PROFESIONALE**

### **Analiza e dokumentacionit vendor (përshkrimi i vendit të punës, klasifikimi kombëtar i profesioneve, etj)**

Dokumentacioni vendor është shpesh herë një burim i dobishëm i informacioneve fillestare. Një analizues profesional mund ta shfrytëzoj këtë burim për përkufizimin e profesionit dhe identifikimit të shkathtësive kryesore që nga fillimi.

### **Analiza e dokumentacionit ndërkombëtar (ISCO,standartet profesionale nga vendet tjera)**

Kjo teknikë është gjithashtu e dobishme veçanërisht në fazën fillestare të analizës, e cila mund të siguroj informata të vlefshme mbi trendët e profesioneve të ardhshme, bie fjala kur krahasohet me profesionet e ngjashme të realizuara në vendet më të zhvilluara.

### **Intervistat (e strukturuar ose jo-të strukturuar, nganjëherë të kombinuara me ide)**

Intervista jo-formale jo e strukturuar, e tipit një për një ose intervista grupore i lejon zhvilluesit të standardit që të parashtroj pyetje të hapura dhe fleksibile. Kjo teknikë është e dobishme për hulumtimin e çështjeve më të gjera. Por mund të qoj më shumë në mendime sesa në gjetje të fakteve. Intervista individuale zakonisht është një burim shtesë i informacioneve atëherë kur zhvilluesi i standardit duhet të sqaroj aspekte të caktuara me të dhëna të pamjaftueshme me intervistën në grup si dhe teknika tjera.

Intervista formale është e strukturuar rreth një liste kontrolluese me pyetje të përgatitura, e organizuar si përzierje e hapur-mbyllur pyetjeve të zgjedhjes së problemit dhe pyetjeve të mbyllura.

Intervista mund të mbahet qoftë me një individ ose me grup. Është e rëndësishme të mblidhen në grup praktikantët dhe mbikëqyrësit, në mënyrë që të sigurohen informacione të qarta dhe objektive.

### **Vëzhgimi i drejtpërdrejtë**

Qëllimi i kësaj teknike është të krijoj një imazh të qartë dhe të kuptuarit të një pune ose detyre brenda sfondit të saj, brenda kontekstit social dhe psikologjik. Kur është e shoqëruar me një intervistë individuale ajo rrit cilësinë e informacioneve të grumbulluara. Kjo teknikë ka një shkallë të lartë të besueshmërisë, por kërkon një vëzhgues të aftë me njohuri të profesionit ose detyrës së analizuar në mënyrë që vëzhgimi të ketë kuptim.

**Metodat e bazuara në pyetësor dhe konferenca** janë gjithashtu teknika të përdorura për mbledhjen e të dhënave por edhe pse ato sigurojnë informata të bollshme, në njërën anë janë të kushtueshme dhe marrin shumë kohë, ndërsa në anën tjetër kërkojnë personel të specializuar për kryerjen e analizave.

# ZBATIMI I ANALIZËS PROFESIONALE

Qëllimi i analizës profesionale është të sigurojmë të dhëna që mund të shërbejnë si bazë për standardet profesionale. Zhvilluesit e standardeve duhet të përpiqen të gjejnë të dhëna të hollësishme dhe të veçanta rreth funksioneve të cilat kryhen brenda një profesioni.

## Ekzistojnë katër faza themelore gjatë ndërmarrjes së analizës:

Përkufizimi i Profesionit ;  
Zhvillimin e kornizës së shkathtësive ;  
Identifikimin e funksioneve kryesore ;  
Identifikimi i shkathtësisë, njohurisë dhe qëndrimeve.

### Faza 1: Identifikimi dhe përkufizimi i profesionit

Faza e parë e cilësdo analize është të përkufizohet në mënyrë të qartë fusha profesionale e cila është duke u analizuar.

### Faza 2: Krijimi i Kornizës së Shkathtësive

Faza e dytë e analizës është të krijohet një kornizë e FUSHAVE TË SHKATHTËSIVE të cilat e definojnë profesionin. Kjo nënkupton shkathtësitë teknike dhe jo-teknike. Si punë paraprake e analizës së standardeve zhvilluesi duhet të ndërmarr një hulumtim bazik të profesionit dhe të krijoj një draft të kësaj kornize para fillimit të procesit të analizës. Kjo mund të verifikohet me grupin gjatë diskutimeve fillestare në intervistën grupore të strukturuar. Në vijim është i paraqitur një kornizë e shkathtësive për profesionin e muratorit:

### Shembull Faza 2

Profesioni : Murator

Korniza tregon se muratori ka shkathtësitë të cilat ai/ ajo i aplikon (ose) mund t'i aplikoj në të gjitha këto fusha.

Një veçori e mëtejme e analizës në këtë fazë është se ajo identifikon shkathtësitë jo-teknike por edhe ato teknike. Në këtë kornizë shkathtësitë jo-teknike kanë qenë identifikuar si "shkathtësi të vendit të punës" ose "Shkathtësi të zhvillimit personal". Kjo është një pikë e rëndësishme e analizës meqenëse kompetenca nënkupton shumë më shumë sesa kapaciteti për aplikimin e shkathtësive teknike. Në ndërmarrje ose rishikim të një analize në këtë fazë zhvilluesit e standardeve duhet të kontrollojnë dhe të shohin nëse kjo është identifikuar.

Para se të lëvizim në fazën tjetër, zhvilluesi i standardeve dhe grupi duhet të arrij një konsensus rreth kornizës.

### Faza 3: Identifikimi i funksioneve kryesore

Kjo fazë përfshinë identifikimin e funksioneve kryesore të cilat janë gjetur brenda secilës fushë të shkathtësive kryesore. Funksionet kryesore janë përkufizuar si funksione me bazë të gjerë. Këto funksione kanë karakteristikat si në vijim:

- Se ato janë të përgjithshme, dhe nuk janë specifike për teknologjitë e veçanta, ose lokacionet,
- Se ato integrojnë njohuri dhe shkathtësitë;
- Se ato janë relevante për profesionin

Në zhvillimin e kësaj liste, grupi do të ndryshoj mendim dhe do ta përshkoj materialin i cili është duke u zhvilluar. Kjo është normale pasi që analiza profesionale është një proces përsëritës.

Shkathtësitë e Vendit të Punës	Shkathtësitë e ndërtimit të mureve	Suvatimi i mureve	Shkathtësitë e lidhura me ndërtimin e mureve	Shkathtësitë e zhvillimit Personal
--------------------------------	------------------------------------	-------------------	--	------------------------------------

Gjatë krijimit të kësaj liste duhet të kërkoj detaje, të hulumtoj gjerësisht për të siguruar se grupi është duke menduar për profesionin si tersi, jo vetëm punën e tyre për të.

Përfundimisht një konsensus do të del në lidhje me listën e krijuar. Nuk ka asnjë rregull të dhënë rreth

numrit të funksioneve kryesore që do të gjenden brenda një profesioni, por në përgjithësi zhvilluesit e standardeve duhet të shikojnë mes 12 dhe 20 funksioneve kryesore.

Totali i funksioneve pasqyron profesionin. Pas Fazës 3 analiza profesionale do duhej të ishte një tabelë e ngjashme me atë në vijim:

FUSHAT E SHKATHTËSIVE	FUNKSIONET KRYESORE				
<b>Shkathtësitë e vendit të punës</b>	Organizmi i vendit të punës	Planifikimi i aktiviteteve të punës	Mirëmbajtja e kushteve të sigurta në vendin e punës		
<b>Shkathtësitë për ndërtimin e mureve</b>	Ndërtimi i mureve masonare	Ndërtimi i mureve dhe shtresave të gipsit	Ndërtimi i mureve nga guri		
<b>Shkathtësitë e lidhura me ndërtimin e mureve</b>	Përgatitja e suvatimit- Ilaçit	Blerja dhe deponimi i materialeve të ndërtimit	Mirëmbajtja e mjeteve të punës	Aplikimi i kontrollit të cilësisë	
<b>Suvatimi i mureve</b>	Mbulimi i mureve me Ilaç				
<b>Shkathtësitë e zhvillimit personal</b>	Përditësimi njohurive dhe shkathtësive				

#### Faza 4: Analiza e shkathtësive

Gjatë kësaj faze zhvilluesi i standardeve fton grupin për të menduar rreth asaj se çfarë ndodh gjatë kryerjes së secilit funksion kryesor i cili ishte identifikuar më parë. Për ta ftuar grupin që të mendoj për procesin, zhvilluesi i standardeve duhet t'i përzgjedh funksionet kryesore dhe t'i analizoj ato për të përcaktuar të dhënat që kërkohen. Qëllimi është që të krijohet një orar për secilin funksion kryesor i cili mbulon pikat në vijim:

- Një listë me **aktivitetet kyçe, procedurat dhe detyrat** të cilat mund të përbëjnë funksionin kryesor.
- **Njohuritë e kërkuara për të kryer dhe për të bërë gjykime gjatë kryerjes së funksionit.**
- **Qëndrimet** të cilat duhet të jenë të pranishme nëse funksioni duhet të kryhet në mënyrë të duhur
- Standardet e Përformancës dhe karakteristikat të cilat zakonisht zbatohet për aktivitetet të përfshira në kuadër të funksioneve
- Shkathtësitë e komunikimit dhe ato ndër-njerëzore nëse është e domosdoshme

Në vijim kemi paraqitur listën me pyetjet të cilat duhet të përdoren nga zhvilluesi i standardeve në fazën e tretë dhe të katër të punëtorisë/seminarit:

Çfarë do të bëni saktësisht gjatë kryerjes së këtij aktiviteti?

Çfarë lloji / tipi të...?

Si bëhet kjo...?

A ka ndonjë gjë tjetër që doni të thoni për procesin?

Çfarë tjetër do bëni në këtë fushë?

Më tregoni më shumë në lidhje me këtë?

Çfarë lloje të përgjegjësive janë të përfshira këtu?

Kur e bëni këtë çfarë gjërash kërkohet që t'i dini?


Çfarë lloje gjykimesh do të bëni gjatë kohës që e bëni këtë?

Si e dini që procesi ka diçka të mirë?


Çfarë e bënë atë të mirë?

Lista nuk është përfundimtare dhe në çdo seminar do të dalin gjëra tjera për tu shtuar.

#### 4 FAZAT E ANALIZES PROFESIONALE



#### 4 FAZAT E ANALIZËS PROFESIONALE: PUNËTOR I KUALIFIKUAR NË INDUSTRIJË DHE NDËRTIMIT





## FORMATI I MUNDSHËM QË REZULTON NGA ANALIZA E SHKATHTËSIVE

Funksioni Kryesor: Ndërtimi i mureve masonare						
A	B	C	D	E	F	G
Aktivitetet Kyçe (dhe rezultatet)	Procedurat dhe detyrat e lidhura për secilin funksion	Kriteri i Përformancës (rezultatet + niveli i krahasimit të cilësisë)	Njohuria e kërkuar për të kryer funksionin	Shkathtësitë	Qëndrimet	Komunikimi dhe sjellja ndër-njerëzore e lidhur me secilin funksion
<p>Identifikimi i formës dhe veçorive të mureve që do të ngritën / ndërtohen</p> <p>Ndërtimi i mureve masonare të formave të ndryshme</p> <p>Verifikimi i cilësisë së mureve të ndërtuara</p>	<p>Analizimi i plan projektit dhe detaje të inxhinierit</p> <p>Përgatitja e shtresës mbështetëse</p> <p>Përgatitja ose blerja e llaçit</p> <p>Përzgjedhja e tullave</p> <p>Prerja dhe formësimi i tullave</p> <p>Renditja e tullave dhe shtesës së llaçit</p>	<p>Forma dhe karakteristikat e shtesës mbështetëse përbushin kërkesat e cilësisë</p> <p>Llaçi i përgatitur ose i blerë në përputhje me specifikat e planit ose sipas rekomandimeve të inxhinierit</p> <p>Muret e ndërtuara në përputhje me formën dhe cilësinë e specifikuar në plan projekt.</p> <p>Parandalimi i rreziqeve për veten dhe të tjerët të ndryshme gjatë kryerjes së punës.</p> <p>Përdorimi i veglave dhe mjeteve të përshtatshme</p>	<p>Grafika bazike e inxhinierisë</p> <p>Receta për përgatitjen e llaçit</p> <p>Procedurat për sigurimin e cilësisë të veçanta për fushën e masonerisë.</p> <p>Rregullat për ndërtimin e formave të ndryshme të mureve</p> <p>Normat e shëndetit dhe sigurisë të veçanta për industrinë e ndërtimit dhe për terrenet e ndërtimit</p> <p>Veglat e veçanta për ndërtim dhe verifikimin e cilësisë</p>	<p>Punimi me mjete të veçanta dhe paisje për matjen e gjatësisë, peshës, dhe vëllimit</p> <p>- prerja e tullave</p> <p>- ndërtimi ose ngritja e mureve</p> <p>- përgatitja e llaçit</p>	<p>Vëmendja</p> <p>Përgjegjësia</p> <p>Përbushja e afateve kohore</p>	<p>Komunikimi (bazik)</p> <p>Puna ekipore (bazik)</p> <p>Vetëdijesimi i konsumatorit (bazik)</p> <p>Zgjidhja e Problemit (bazik)</p>

# VERIFIKIMI DHE VALIDIMI I TË DHËNAVE

## QË REZULTOJNË NGA ANALIZA PROFESIONALE

Pas mbledhjes dhe organizimit të dhënave, por para se këto të fundit t'i dërgohen ekipit hartues për zhvillimin e standardeve profesionale, këto duhet të kontrollohen për saktësi dhe gjerësi. Procesi i verifikimit mund të bëhet me ata që kanë sjell informatën në radhë të parë, ekipi i hartimit të cilët janë ekspertë të profesionit përkatës. Ndërsa ata që bëjnë verifikimin e të dhënave duhet të pajisen me materiale dhe nga ata të kërkojnë komente qoftë verbale ose me shkrim.

### Zhvillimi i Standardeve Profesionale

#### Formati i standardeve profesionale

Ku është e mundur, zhvilluesit duhet të përvetësojnë një format të përgjithshëm për shkrimin e standardeve. Kjo nuk nënkupton se të gjitha standardet profesionale duhet të kenë dukje të njëjtë, por duhet të bazohen në parime të përbashkëta, pra, të gjitha standardet duhet të tregojnë diçka në lidhje me **aktivitetet kyçe** të cilat duhet ti ndërmarr personi, **të kuptuarit dhe njohurinë që ata duhet ta kenë, gjërat të cilat ata mund ti bëjnë mirë dhe ambientin në të cilin ata do t'i ndërmarrin ato funksione.** Formatet janë të dobishme. Në kontekstin kombëtar, standardet duhet të zhvillohen rreth një formati të gjerë dhe të përbashkët.

Një format i përbashkët lejon:

- Njohjen e kompetencave përgjatë profesionit;
- Të kuptuarit e përbashkët se çfarë do të thotë standard profesional

Formati zberthen profesionin në një gamë të funksioneve të gjera. Secili funksion i gjerë vetvetiu është e zberthyer në një seri të funksioneve kyçe, e cila tutje përshkruan dhe siguron më shumë informata mbi kërkesat e funksionit të gjerë.

Për secilin aktivitet kyç identifikohet një seri e deklaratave të performancës. Këto përshkruajnë rezultatin ose realizmin i cili duhet të arrihet nëse kompetenca e përshkruan në aktivitetin kyç dhe funksionet e gjëra janë duke u realizuar në mënyrë të suksesshme.

Zhvilluesit e standardeve profesionale gjithashtu do të kenë mundësinë e shtimit të kategorive tjera të informacioneve për ta bërë kontekstin e standardit më të qartë ose për të dhënë më tepër udhëzime mbi dëshmitë e kërkuara për vlerësimin e suksesshëm të individëve kundruall standardit të caktuar.

#### Përmbajtja e Standardit Profesional

Standardet Profesionale janë rreth realizmit /performancës, duke përfshirë të dyja :

- aftësinë për të kryer me sukses funksionet e kërkuara në një profesion; dhe
- aplikimin e njohurisë dhe të kuptuarit e një profesioni.

Duke qenë kompetent në standarde profesionale nga individët do të pritet që të:

- aplikon shkathtësitë teknike
- sjell gjykime dhe vendime;
- ushtrojnë kreativitet;
- organizon dhe administron punën ;
- punon me të tjerët si anëtar i ekipit;
- komunikon në mënyrë efektive;
- merret me natyrën e ambientit të punës, duke përfshirë kapacitetin për t'u marr me gjëra të papritura dhe të paparashikuara.

## Formati i përgjithshëm i standardeve profesional

### **Funksioni**

Një funksion i rëndësishëm në profesion

### **Aktiviteti Kyç**

Aktivitetet dhe detyrat e rëndësishme të lidhura me kryerjen e punës së funksionit

### **Kriteri i Përfundimit**

Deklarata në lidhje me atë se çfarë pritet që personi të arrij duke përfshirë edhe cilësinë e rezultateve dhe

### **Kushtet e realizimit të funksionit**

Kontekstin brenda së cilit duhet të arrihet performanca (vendet, llojet e mjeteve, materialet, klientët, etj.)

### **Deklarata e Dëshmive**

Llojet e dëshmisë të cilat do të tregojnë se personi është kompetent

# PËRCAKTIMI I FUNKSIONEVE DHE AKTIVITETEVE KYÇE

## Fushat e Shkathtësive

Hartimi i standardeve fillon me identifikimin e Fushave të Shkathtësive brenda profesionit. Këto janë përshkrimet e grupeve të shkathtësive kryesore që janë gjetur brenda profesionit këto grupe të përgjithshme do të jenë shkathtësitë jo-teknike dhe teknike të cilat duhet t'i kenë njerëzit nëse ata donë të jenë kompetent në një profesion. Për shembull një punëtor i magazinës do të ketë kompetencat që bien në kuadër të Fushave të Shkathtësisë së

- Proceseve dhe sistemeve të magazinës
- Trajtimi i asortimenteve
- Shërbimi i konsumatorit
- Mbikëqyrja

Ose ngjashëm një murator mund të ketë kompetencat në fushat e shkathtësive të përgjithshme të

- Prishjes së mureve
- Ndërtimit të mureve
- Suvatimi i mureve

Brenda secilës fushe të shkathtësive zhvilluesit e standardeve to të identifikojnë njësitë e kompetencës. Për shembull, Fusha e Shkathtësisë të Ndërtimit të mureve, hartuesi i standardeve mund të hartoj njësitë e kompetencës të titulluara:

- Ndërto muret me tulla të kompleksitetin të lartë
- Ndërtimi i mureve të thjeshta me tulla
- Ndërtimi i mureve të gipsit të formave të ndryshme

Identifikimi i fushës së shkathtësive është një vegël e vlefshme dhe ndihmë për të dhënat profesionale të organizatës meqenëse rezulton nga analiza dhe është e shkruar / hartuar nga hartuesit e standardeve.

Zakonisht zhvilluesit e standardeve do ta kenë të përgatitur kornizën e fushave të shkathtësive. Është thelbësore që të dy zhvilluesit e analizës së shkathtësive dhe hartuesit e standardeve të përdorin Fushat e shkathtësive si temë për analizën dhe zhvillimin e standardeve të tyre.

## Zhvillimi i Funksioneve

Identifikimi i fushave të shkathtësisë është një detyrë relativisht e lehtë e cila mund të ndërmerret nga dikush që është i familjarizuar me profesionin ose dikush që ka ndërmarr ndonjë hulumtim. Funksionet janë komponente të rëndësishme të standardeve profesionale.

